

**PROCESVERBAL**

**nga seanca e 2-të publike e Këshillit të Agjencisë për Shërbime  
Mediatike Audio dhe Audiovizuale  
mbajtur më 28.02.2025**

**Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë:** Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, Lazar Trajçev, dr. Metodija Jançeski, Zoran Fidanoski.

**Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë:/**

**Në seancë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.**

**Të pranishëm nga Shërbimi profesional:** mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, Goran Radunoviq, Maja Damevska, dr.Ivana Stojanovska.

**Të pranishmit e tjerë: /**

Kryetari i Këshillit, Lazo Petrushevski hapi seancën e 2-të publike të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 15:30 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave, kati i dytë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi si vijon:

**RENDIN E DITËS**

1. Arsyetim nga Shoqëria Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV Shutel SHPKNJP Shkup, për veprimin e medias në lidhje me procedurën e inicuar për heqjen e lejes.
2. Të ndryshme.

**Pika 1**

Z. Petrushevski konstatoi se në seancë nuk kishte të pranishëm përfaqësues nga Shoqëria Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV Shutel SHPKNJP Shkup. Meqënëse, sipas Ligjit, seanca është caktuar për shpjegimin e medias në lidhje me procedurën e inicuar për heqjen e lejes, seancën e deklaroi të mbyllur.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**